

## Komuna e Dragashit/Dragaš

### Hashim (Halit) Ajupi

(17.09.1981, shqiptar nga Zymi/Zjum, komuna e Dragashit/Dragaš, nxënës, i pamartuar)

Hashimi i kishte katër motra dhe dy vëllezër. Me prindërit e vet jetonin në shtëpinë e cila ishte afro 200 metra larg më vijë ajrore nga kodra e *Trojzës* përmbi fshat. Që nga data 13.07.1998, mbi këtë kodër ishte stacionuar ushtria serbe me uniforma të larmishme maskuese. Në mbrëmjen e datës **17.07.1998**, Hashimi dhe Resmija ishin duke e shikuar televizionin në dhomë e cila ishte e kthyer nga *Trojza*. Vëllezërit dhe motrat e tjera gjendeshin nëpër dhoma të tjera. Nga ora 22:00 u dëgjuan krisma të forta armësh, nga të cilat u thyen xhamat e dhomës ku gjendeshin Hashimi dhe Resmija [*Zym/Zjum*]. Motra e Hashimit e ka parë atë duke ulëritur nga dhembja dhe duke u çuar nga krevati me dorën që e mbante në stomak. I ndihmoi që të largohej nga dhoma në korridor, nga ku dolën në ballkon. Atje, Hashimin e qëlluan sërish me plumb në dorën e majtë. Vëllai i tyre Muharremi ka ardhur nga dhoma tjetër dhe i futi që të dy në dhomë. Hashimi ka dhënë shpirt në duart e tij. Në mëngjes, kushërinjtë e Hashimit kanë shkuar në *Trojzë* dhe kanë kërkuar që ushtarët të mos shtënin gjatë varrimit të Hashimit. I akuzuan ushtarët që ata e kishin vranë Hashimin. Komandanti i ushtrisë, i cili sapo kishte arritur nga Dragashi/Dragaš, nuk ka dhënë leje për varrimin e Hashimit në varrezat e fshatit. U tha që ta varrosnin në oborr dhe gazetarëve tu deklarojnë se ushtria nuk e kishte vranë Hashimin. Në të njëjtën ditë, më 18.07.1998, Hashimin

e kanë varrosur në oborrin e shtëpisë familjare. Pas lufte, familjarët në prani të mjekëve i kanë zhvarrosur mbetjet mortore të Hashimit më 15.09.1999 dhe i ka rivarrosur ato në varrezat e fshatit Zym/Zjum. Gjatë kontrollit, mjekët kanë konstatuar se Hashimin e kishin vranë me dy plumba në bark dhe një në dorë.

**Burimet:** deklarata R.K, FDH-40611; J. Osmani, *Krimet...*, I, 160.

---

### Nexhat (Qazim) Fanaj

(25.09.1965, shqiptar nga Grazhdaniku/Grazhdanik, komuna e Prizrenit/Prizren, dy fëmijë, pjesëtar i UÇK-së)

### Behamir (Rrustem) Memaj

(23.10.1973, shqiptar nga Zhuri/Žur, komuna e Prizrenit/Prizren, i martuar, pjesëtar i UÇK-së)

Nexhati ka punuar në Zvicër, por u kthye në vitin 1998, për t'iu bashkuar UÇK-së. Në UÇK aderoi edhe Behamiri për të ndihmuar luftën kundër regjimit serb. Më datën **28.07.1998**, Nexhati dhe Behamiri e kanë sjell një kontingjent armatimesh nga Shqipëria në Kosovë, ndërsa më pas kanë shkuar në fshatin **Buçë/Buča**. Një kohë qëndruan në këtë fshat, ndërsa kur u nisën me një grup pjesëtarësh të UÇK-së, u ndeshën me ushtarët e Ushtrisë së Jugosllavisë. Në shkëmbimin e zjarrit mes dy anëve Nexhati dhe Behamiri gjetën vdekjen, kurse pjesëtarë të tjerë të UÇK-së u arrestuan. Pas disa ditësh, familjarët i morën trupat e Nexhatit dhe Behamirit dhe i varrosën në fshatrat e tyre të lindjes. Pas lufte, trupat e Nexhatit dhe Behamirit janë rivarrosur në Varrezat e Dëshmorëve të Luftës në